

**BASHKIA TIRANË
NDËRMARRJA E DEKORIT DHE EVENTEVE**

Data 14/04/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: Blerje karburant

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 09134100-8

Vlera e fondit limit: 2,500,000 (dymilionepeseqind) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Subjekti duhet të paraqesë licencë profesionale per prodhim/ose furnizim te mallrave objekt kontrate te leshuara nga organet kompetente. OE duhet te paraqese vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që te provoje se ka importuar dhe /ose ka tregetuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar dhe ofertuesi nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë të karburantit, për vitin 2025.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.*

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma*

d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara,

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë flete-analize për produktin Benzine pa plumb duhet të jetë sipas Standard-it SSHEN 228:2012 + A1:2017 dhe Diesel S SH EN 590:2022 të lëshuara nga organi kompetent ose nga një laborator shqipëtar ode i huaj që vërteton cilësitë e produktit objekt i kesaj kontate që ofertuesi tregton sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmeri me specifikimet teknike të lëshuara jo më parë se 6 muaj.

Këto kritere janë vendosur që operatorët ekonomik të jenë të pajisur sipas ligjit me lejet dhe autorizimet përkatëse për tregtimin e këtij malli, në zbatim të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015. VKM-në me nr.538

datë 26.05.2009,vkm, Ligji nr.8450 dt.24.02.1999), si dhe ne perputhje me rekomandimin nr 5168 prot date 18.07.2024

Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnë se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur. Pra konsiderohen si kriteret të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet dhe i bazuar në LPP.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 2 Stacione tregtimi karburanti në territorin e Bashkise Tirane te vertetuar me Niptin përkatës dhe të pasqyruara në Ekstraktin e shoqërisë.

Këto stacione të jenë të pajisura me Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitje me pakice, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a- Lejen e mjedisit sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin, lëshuar nga QKL;
- b- Vërtetim Teknik lëshuar nga ISHTI / nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- c- Çertifikatë e mbrotjes nga zjarri/Akt teknik lëshuar nga MZSH;
- d- Policë sigurimi lëshuar nga shoqeritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë,

(të gjitha dokumentat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nennt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, në ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. Në lidhje me kriterin e lejes mjedisore kjo kërkesë është referuar ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, i ndryshuar me ligjin nr. 60/2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 152 date 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, të ndryshuar.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat mjedisore duke garantuar reduktimin, minimizimin apo shmangin e ndikimeve në mjedis të instalimeve ndotëse, duke respektuar standartet kombëtare. Akti teknik lëshuar nga MZSH është i rëndësishëm, pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marrë masa dhe vepron në përputhje me legjislacion Shqiptar.

2.3.4 Në mbështetje të V.K.M-së Nr.561, datë 29.07.2016 “Për standardizimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “furnizimi me karburant për automjetet duhet të kryhet nëpërmjet **kartës elektronike**, e cila të mundësojë identifikimin e mjetit dhe përdoruesin e tij. Kartat elektronike duhet të jenë **pa afat skadence** deri në përfundimin e plotë të kontratës.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure si dhe bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 40 pika 6, gjurmë ”c” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: *OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

NJËSIA E PROKURIMIT

Arjela Hoxha

Fetie Beraj

Irena Liço